

## **VLERËSIMIN NDËRKOMBËTAR PISA 2012 PËR SHQIPËRINË DO TË KRYHET NË MUAJIN PRILL.**

### **Shqipëria dhe pjesmarrja e saj në PISA**

Në muajin prill në Shqipëri do të kryhet vlerësimi ndërkombëtar PISA 2012. Kjo është hera e tretë që vendi ynë merr pjesë në këtë vlerësim ndërkombëtar të rëndësishëm.

PISA është **Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve\***, mbështetur nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). PISA 2012 është studimi i pestë i PISA-s që ka nisur që nga viti 2000 dhe përfshin më shumë se 60 vende pjesëmarrëse.

Studimi Ndërkombëtar PISA zhvillohet çdo tre vjetë duke nisur që në vitin 2000.

Për çdo studim, një nga tre fushat e studimit trajtohen si fusha themelore e studimit së cilës i jepet më shumë rëndësi dhe hapësirë gjatë periudhës së studimit.

Në vitin 2012 fushë kryesore e vlerësimit PISA do të jetë matematika

Në vitin 2000 fusha themelore e studimit ishte Leximi, në 2003 ishte Matematika dhe në 2006 Shkencat Natyrore. Në vitin 2009 fushë kryesore vlerësimi ishte përsëri Leximi.

### **Përmbajtja e vlerësimit PISA**

Vlerësimi i PISA-s fokusohet në aftësinë që kanë nxënësit 15 vjeçarë për t'i përdorur dijet dhe aftësitë e fituara në shkollë në situatat reale të jetës të një të rrituri.

PISA është studimi më i madh ndërkombëtar në botë për arsimin. Ajo mat arritjet e nxënësve në **Lexim, Matematikë dhe Shkencë**.

### **Në lexim**

PISA vlerëson shkallën në të cilën nxënësit mund të përdorin aftësitë e tyre të leximit për të interpretuar lloje të ndryshme të materialeve të shkruara, materiale me të cilat ata ndeshen në jetën e tyre të përditshme;

### **Në matematikë**

PISA vlerëson shkallën në të cilën nxënësit mund të përdorin aftësitë e tyre dhe dijet në fushën e Matematikës në zgjidhjen e problemave dhe sfidave të ndryshme lidhur me Matematikën

### **Në shkenca**

PISA vlerëson shkallën në të cilën nxënësit mund të përdorin aftësitë e tyre dhe dijet në fushën e Shkencave Natyrore në kuptimin dhe interpretimin e fenomeneve të ndryshme, në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme shkencore.

### **Instrumentat e vlerësimit**

Instrumentat kryesorë në vlerësimet PISA janë testet dhe pyetësorët. Nxënësit e përzgjedhur do t'i nënshtrohen një testi me shkrim prej 2 orë e gjysmë, test ky që konsiston në pyetje rreth lëndëve të Matematikës, Shkencave dhe Leximit. Gjithashtu, këta nxënës do të plotësojnë edhe një pyetësor që është Pyetësori i Nxënësit. Përveç kësaj, shkollave do t'iu kërkohet të plotësojnë një pyetësor që është Pyetësori i Shkollës.

## **Testet dhe lloji pyetjeve të përdorura**

Testet kanë pyetje ku përgjigja jepet duke qarkuar alternativën e saktë dhe pyetje të hapura që u kërkojnë nxënësve ta strukturojnë vetë përgjigjen që japin.

## **Pyetësorët**

### **Pyetësi i nxënësit**

Në vlerësimin PISA 2012 për Shqipërinë do të përdoren pyetësi I nxënësit dhe pyetësi I shkollës. Pyetësi I nxënësit do të plotësohet nga nxënësi që merr pjesë në testim. Pra çdo nxënës I përzgjedhur për testim I përgjigjet testit dhe plotëson pyetësin e nxënësit. Nxënësit i përgjigjen pyetësorit që studion formimin e tyre, duke dhënë informacion për veten, familjet dhe qëndrimin e tyre ndaj të mësuarit. Pyetësi u merr atyre 20-30 minuta për ta plotësuar

### **Pyetësi i Shkollës**

Pyetësi i shkollës është një për çdo shkollë të përzgjedhur dhe plotësohet nga drejtuesit e shkollës, për të cilin atyre u duhen 20 minuta për ta plotësuar.

Informacioni që mblidhet nga këta pyetësorë i ndihmon vendet të studiojnë efekte të ndryshme që ndikojnë në performancën e nxënësve, si psh. faktorët shoqëror-ekonomikë, faktori gjinor, faktori racial, faktori familje, etj. Këto pyetësorë ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve të qarta dhe detyrave që i dalin para çdo sistemi arsimor.